

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, në çështjen juridike të paditëses: të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim kundër të paditurit: nga baza e kontestit: Borxh, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë: 30.06.2015, me date 15.09.2015 bie këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- **REFUZOHET** si e Pa Bazuar kërkesëpapia e paditëses kundër të paditurës: për pagesën e borgjit në shume prej 94.38 euro në emër të shfrytëzimit të shërbimeve telefonike pasi borxhi i të paditurës ndaj paditëses është përfshirë në falje me Ligjin për Faljen e Borgjeve Publike
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

### **A r s y e t i m**

Paditësja me datë: 30.06.2009 ka parashtruar në gjykatë propozim për përmbarim i cili propozim është lejuar me aktvendimin e datës: 09.10.2014. Debitorja- E paditura ka paraqitur kundërshtim ndaj aktvendimit në fjalë me datë:22.12.2014.

Me datë: 22.12.2014 është vënë jashtë fuqie aktvendimi për përmbarim dhe tani propozimi i kreditorit është trajtuar padi, kurse kundërshtimi i debitorit është trajtuar si përgjigje në padi.

Gjykata me datë: 30.06.2015 ka caktuar seancën kryesore në këtë çështje ku në seancë prezantoi përfaqësuesi i paditëses ndërsa mungoi e paditura edhe pse ishte ftuar me rregull mungesën nuk e arsyetoi. Seanca në këtë çështje u mbajt në mungesë të të paditurës.

Në seancë dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, duke shtuar se e paditura me paditësen kanë pasur marrëveshje për shfrytëzimin e telefonisë fikse gjegjësisht numrit dhe se paditësja i ka ofruar këto shërbime konform marrëveshjes dhe kërkoi nga gjykata që të padituren ta obligoi ta kompensoi shumën në vlerë prej 94.38 euro në llogari të paditëses.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: fatura për muajin 05,06, 07, 08, 09, 10, 11, dhe 12 të vitit 2008, 01,02, 03 të vitit 2009 kundërshtimi i të paditësës E.nr.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Nuk është kontestues fakti se e padituri ka qenë shfrytëzuese e shërbimeve telefonike, pasi kjo vërtetohet nga ana e faturave të cekura më lartë.

Se e padituri i ka paditëses borxh, vërtetohet pikërisht në bazë të faturave Nr. ff. për muajin 05,06,07,08,09,10,11 dhe 12 të vitit 2008 dhe 01,02 dhe 03 të vitit 2009.

Gjykata, me rastin e vendosjes morri parasysh pretendimet dhe kundërshtimet e të paditurit, se e njëjta nuk i ka krijuar këto hargjime dhe nuk e ka përdorur telefonin gjatë kësaj periudhe dhe se ajo ka kërkuar disa herë të ndërpritet ky numër i telefonit.

Kundërshtimi i të paditurës si i tillë mbetet në nivelin deklarativ, pasi me asnjë provë të vetme e paditura nuk i vërtetoi pretendimet e veta.

Gjykata duke analizuar kundërshtimin në fjale në raport me faturat si bazë më të fortë mori faturat duke marrë për bazë se fuqinë juridike ia ka dhënë ligji sepse faturat kanë fuqinë e dokumentit autentik, dhe në bazë të tyre mund të filloi procedura përmbarimore.

Në lidhje me qështjen e ngarkimit të faturave për parapagim mujor, gjykata konsideroi se kjo qështje është sqaruar me rregullativën ligjore të paditëses, dhe këtë fakt me rastin e nënshkrimit të kontratës e kanë të njohur edhe klientët, dhe se mirëmbajtja apo ruajtja e numrit paguhet në formë paushalle me një shumë të caktuar që është e njëjtë në secilin muaj.

E paditura në kundërshtim e saj e cek se disa hherë ka kërkuar që të ndërpritet telefoni, mirëpo e njëjta nuk ka dorëzuar asnjë provë, po ashtu e njëjta nuk ka vërtetuar me asnjë provë ndonjë reklamim-kundërshtim të faturave.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate nga prova e administruara pa mëdyshje u vërtetua ekzistimi i borgjit të të paditurës ndaj paditëse, mirëpo duke marrë parasysh se borgji i kërkuar në padi është nën shumën 100 euro, sipas Ligjit për faljen e Borgjeve Publike, ky borgj shlyhet në mënyrë automatike, andaj gjykata nuk mund të aprovon kërkesëpadinë e paditëses duke u mbështetur në këtë rrethanë.

Gjykata konform nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit për Faljen e Borgjeve Publike vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të LPK-së,

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
C.Nr.855/2014 datë: 15.09.2015

**GJYQTARI**  
Faton Ademi



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.